

Data 21/07/2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR
KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Mbështetje për Programin Operacional 2026-2029: Paketa B- Shërbime Konsulence, Projektimi dhe Mbikëqyrje për ndërhyrjet e permiresimit të shtresave asfaltike - Qarku (Elbasan, Korçë, Berat, Vlorë, Fier dhe Gjirokastër)”.
1

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 73300000-5; 71247000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: **26,755,372 lekë** pa TVSH, **Euro 285,786.93**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe”, autoriteti/enti kontraktor FSHZH ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik."

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e marrëveshjes kuadër në procedurën e prokurimit.

Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmin e tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe pika 2/b e nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: "Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata."

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet **financiare 2023, 2024, 2025** të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në nenin 41, pika "b", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmin e tyre .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja b” të Ligjit nr. 1009/2009: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të marrëveshjes kuadër. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe

faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 41 pika 3 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Ky kriter vërteton eksperiencën në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Përvoja e operatorit është një element i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qëndrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Në kuptim të nenit 41 te VKM-se 285/2021 vlerësohet vlera e kërkuar në masen jo më të vogël se 30 % të vlerës së përlogaritur të marrëveshjes që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. e cila është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës rrjedhimisht nuk sjellë kufizim të pjesëmarrjes në garë të operatorëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për projekttime dhe mbikëqyrje të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e projektimit duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

i- Licensat e kerkuara ne projektim:

- | | |
|--------|--|
| 5 d: | Projektim vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) - damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino; |
| 6 a,b: | Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore-Projektim rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore; |
| 7 a: | Projektim ura dhe vepra arti deri me 10m; |
| 8 a,b: | Rilevime inxhinierike-rilevime inxhinierike kadastrale. |
| 9 a,d: | Studim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte deri 5 kate; Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët. |
| 10 e: | Projektim kabina elektrike në rrjetin shpërndarës - linja të tensioni të ulet – të mesëm. |
| 11 a: | Sinjalistikë jondricuese në rrugë lokale, urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe dhe parkim. |

Specialisti i mjedisit duhet te zoteroj certifikate ne perputhje me Ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 i ndryshuar me Ligjin 128/2020.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti operatori ekonomik duhet te paraqese licensen e shoqerise.

ii)-Licensat e kërkuara në mbikëqyrje

- N.P – 1. Punime gjurmimi në tokë.
- N.P – 4. Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- N.P – 5. Punime nëntoksore, ura e vepra arti.
- N.P – 12. Punime të inxhinierisë së mjedisit.

iii)-Për mbikëqyrjen e punimeve speciale të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- N S – 1. Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S – 6. Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- N S – 7. Barriera dhe mbrojtje rrugore.
- N.S – 18. Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (VKM nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim).

-Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.201”, si dhe VKM Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale” dhe teknikisht në Termat e Referencë sipas tipologjisë së objekteve kulturore. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve objekt të kontratës të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës shërbimin e projektimit dhe të mbikëqyrjes. Sa i përket shërbimit të projektimit Kategoritë e mesiperme janë përcaktuar në perputhje me Termat e Referencës tipologjinë e Ndërhyrjet e kësaj pakete do të përfshijnë: •Frezim i shtresës ekzistuese asfaltike në segmentet ku

konstatohet dëmtim, konsumim ose deformim i sipërfaqes rrugore, me qëllim përgatitjen e bazës për ndërhyrjet pasuese. •Trajtim i sipërfaqes rrugore ekzistuese, në varësi të gjendjes teknike të saj, për përmirësimin e qëndrueshmërisë, nivelimit dhe cilësisë së qarkullimit. •Riparim pjesor i shtresave rrugore në zonat ku evidentohen çarje, gropa, ulje lokale, dëmtime të bazamentit apo problematika të tjera që ndikojnë në sigurinë dhe komoditetin e lëvizjes. •Ndërhyrje të kombinuara në shtresat rrugore, sipas nevojave konkrete të evidentuara gjatë verifikimit në terren dhe vlerësimit teknik të çdo segmenti. •Përmirësim i shtresave asfaltike për rritjen e jetëgjatësisë së rrugës, uljen e kostove të mirëmbajtjes dhe përmirësimin e kushteve të transportit rrugor. •Plotësim ose përmirësim i elementeve të sigurisë rrugore, përfshirë sinjalistikën horizontale dhe vertikale, aty ku do të rezultojë e nevojshme nga analiza teknike. •Përmirësim i kushteve të drenazhimit dhe largimit të ujërave sipërfaqësore në segmentet ku problematikat e kullimit ndikojnë në dëmtimin e shtresave rrugore. •Aplikim i ndërhyrjeve të përshtatura sipas tipologjisë së rrugës, intensitetit të trafikut, gjendjes ekzistuese të shtresave dhe rëndësisë funksionale të segmentit në rrjetin rrugor lokal apo rajonal. •Vendosje dhe përmirësim i elementeve të sinjalistikës horizontale dhe vertikale, si dhe i pajisjeve dhe masave plotësuese për rritjen e sigurisë rrugore në segmentet ku do të kryhen ndërhyrjet. Ndërkohë për shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve në zbatim kategorite e mesiperme janë përcaktuar në përputhje me Termat e References dhe natyrën e kontratës.

2.3.3 Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet të paraqesin një listë të stafit kryesor të meposhtem, të cilet duhet të kenë një marrëdhënie kontraktore me operatorin apo partnerin në rastin e një bashkimi operatorësh. I gjithë stafi kryesor i kërkuar duhet të jetë i licensuar në shërbimet e projektimit dhe mbikëqyrjes si dhe duhet të zotërojnë licensat profesionale sipas kategorive të renditura më sipër, përkatësisht për specialitetin që mbulojnë. Për çdo pozicion, operatorët janë të lirë të propozojnë më shumë se një kandidat, me qëllim përmbushjen e kriterëve të kërkuara.

i)-Pozicionet e stafit kryesor të kërkuar janë:

Tabela për stafin

Stafi për shërbimin e projektimit / mbikëqyrjes	Stafi i projektimit	Stafi i mbikëqyrjes	Total
Drejtuues Projekti (Drejtuues i grupit të projektimit) Projektues (inxhinier me përvojë në projekte rrugësh)	1		1
Projektues Hidroteknik	1	1	2
Projektues Rrugësh / Inxhinier ndërtimi	1	1	2
Projektues Ura dhe Vepra Arti / Inxhinier ndërtimi	1	1	2
Projektues Elektrik	1		1
Projektues Gjeodet	1	1	2
Projektues Gjeolog	1		1
Projektues i sinjalistikës rrugore	1		1
Specialist Mjedisi	1		1
Kontrollor Cilësie		1	1
Kontrollor i vëllimeve të punës		1	1

Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE)		1	1
Total	9	7	16

ii) Licensat qe duhet te zoteroje stafi kryesor i projektimit:

Drejtues Projekti (Drejtues i grupit te projektimit)	*
Projektues Hidroteknik	5 d;
Projektues Rrugesh	6 a,b;
Projektues Vepra Arti	7 a;
Projektues Gjeodet	8 a,b;

- Drejtues Projekti* duhet te jete (Projektues Rrugesh).
- Drejtuesi i Projektit, Projektuesi Vepra Arti, Projektuesi gjeodet, Projektuesi hidroteknik), duhet të jenë pjese e stafit të shoqërisë dhe të figurojnë në listëpagesat e punonjesve të shoqërisë për për periudhen 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit.
- Inxhinier Ndertimi, Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier Gjeodet, duhet të jenë pjese e stafit të shoqërisë dhe të figurojnë në listëpagesat e punonjesve të shoqërisë për periudhen 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit.
- Operatori ekonomik do duhet që në cdo kantier të ketë një Inxhinier Rezident (per mbikeqyrjen).

Stafi i mësipërm duhet të jetë pjesë e stafit të propozuar për të ndjekur projektin dhe implementimin e punimeve. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti, për secilin prej specialistëve të lartpërmendur Operatorët Ekonomike duhet të paraqesin:

- kualifikimet arsimore (diplomat), kualifikimet profesionale (licencat profesionale), CV, Kontratë pune të vlefshme.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 10. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. _Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

-Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin public" i ndryshuar, në nenin 41 pika 4/b/cte VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates përshkrimit në Termat e Referencës. Ndërhyrjet e kësaj pakete do të përfshijnë: •Frezim i shtresës ekzistuese asfaltike në segmentet ku konstatohet dëmtim, konsumim ose deformim i sipërfaqes rrugore, me qëllim përgatitjen e bazës për ndërhyrjet pasuese. •Trajtim i sipërfaqes rrugore ekzistuese, në varësi të gjendjes teknike të saj, për përmirësimin e qëndrueshmërisë, nivelimit dhe cilësisë së qarkullimit. •Riparim pjesor i shtresave rrugore në zonat ku evidentohen

çarje, gropa, ulje lokale, dëmtime të bazamentit apo problematika të tjera që ndikojnë në sigurinë dhe komoditetin e lëvizjes. •Ndërhyrje të kombinuara në shtresat rrugore, sipas nevojave konkrete të evidentuara gjatë verifikimit në terren dhe vlerësimit teknik të çdo segmenti. •Përmirësim i shtresave asfaltike për rritjen e jetëgjatësisë së rrugës, uljen e kostove të mirëmbajtjes dhe përmirësimin e kushteve të transportit rrugor. •Plotësim ose përmirësim i elementeve të sigurisë rrugore, përfshirë sinjalistikën horizontale dhe vertikale, aty ku do të rezultojë e nevojshme nga analiza teknike. •Përmirësim i kushteve të drenazhimit dhe largimit të ujërave sipërfaqësore në segmentet ku problematikat e kullimit ndikojnë në dëmtimin e shtresave rrugore. •Aplikim i ndërhyrjeve të përshtatura sipas tipologjisë së rrugës, intensitetit të trafikut, gjendjes ekzistuese të shtresave dhe rëndësisë funksionale të segmentit në rrjetin rrugor lokal apo rajonal. •Vendosje dhe përmirësim i elementeve të sinjalistikës horizontale dhe vertikale, si dhe i pajisjeve dhe masave plotësuese për rritjen e sigurisë rrugore në segmentet ku do të kryhen ndërhyrjet, gjykojmë se duhet të kryhet nga një staf profesional i kompeltuar me njohuri për fushat specifike dhe eksperiencën e mjaftueshme, për të garantuar kompletimin e standardeve në fushën përkatëse. Përcaktimi i stafit teknik për projektimin është bazuar tek elementet e produkteve të përcaktuara në termat e references. Kategoritë e licencave bazohen në parashikimet e VKM-së nr.759/2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes se kolaudikimit të punimeve të zbatimit në ndërtim miratuan kriteret teknike dhe profesionale të kualifikimit”. Për të dokumentuar eksperiencën e stafit kryesor, Drejtuesi Projektit (Projektues rrugesh, Arkitekt, Projektues Konstruktor, Projektues hidroteknik), që zëne pjesën më të rëndësishme të punës, gjykojmë të kërkojmë si dokument justifikues listepagesat e punonjesve te shoqerisepër periudhen 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Sa i përket kërkesës për specialistin e mjedisit është e nevojshme që gjatë fazës së zbatimit të kontratës duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë, për këtë qëllim subjekti duhet të jetë i certifikuar ne perputhje me Ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 i ndryshuar me Ligjin 128/2020. Specialisti i mjedisit është një kërkesë e vendosur nisur dhe nga rëndësia e objekteve dhe volumi i punimeve sipas standarteve e kushteve teknike.

Sa i përket kërkesës për Projektues per nderhyrje ne pasurite kulturore vepra arti, kriteri bazohet në VKM Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale” dhe teknikisht në Termat e Referencës sipas tipologjisë së objekteve kulturore.

Kërkesa për Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE) mbështet ne ligjin Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 date 09.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontrates dhe specifikat e sajë kerkojne njohuri e pergatitje te posacme per vleresime te perpikta per te zgjidhur ceshtje qe lidhen me garantimin e sigurise dhe mbrojtjen ne pune. Ne rregulloren per sigurine ne kantier miratuar me VKM nr.312/2010 eshte

percaktuar se punedhenesi per mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet te ndjeke kurse formimi perkates ne fushen e sigurise e te shendetit ne vendin e punes. çdo punedhenes zgjedh nje ose disa persona si pergjegjes per ndihme e pare ne rast emergjencash dhe per sigurine e mbrojtjen e shendetit. Rregullorja percakton kerkesat minimale te sigurise dhe te shendetit ne pune per kantieret e perkohshem ose te levizshem, si dhe masat e pergjithshme te mbikeqyrjes

Kërkesa për stafin teknik për shërbimin e mbikëqyrjes lidhet ngushtësisht me numrin e objekteve të kontratës së zbatimit dhe vendndodhjen e tyre. Nevoja për inxhinierët në objekt/kantier është e diktuar nga përvoja dhe legjislati për punimet e ndërtimit dhe bazuar në VKM nr. 610, datë 22.9.2022. Numri i stafit kryesor teknik për mbikëqyrjen është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllim për të patur një rezultat sa më të mirë dhe cilësor në mbarëvajtjen dhe mbikëqyrjen e punimeve. Stafi teknik i inxhinierëve, kapacitetet dhe aftësitë organizative janë të domosdoshëm gjatë mbikëqyrjes së objekteve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për mbikëqyrjen sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe brenda kushteve të kontratës

Për të dokumentuar eksperiencën përvojën e stafit kryesor /profesional që zë pjesën më të rëndësishme të punës, gjykojmë të kërkojmë kualifikimet arsimore (diplomat), kualifikimet profesionale (licencat profesionale), CV, Kontratë pune të vlefshme.

2.3.4. Numri i punonjësve: Numri i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 7 (shtatë) punonjës për çdo muaj, për periudhën 3 (tre) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, ndërsa stafi tjetër mund të jetë me kontratë shërbimi.

- Për të vërtetuar këtë kusht, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën për periudhën 3 (tre) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, i cili duhet të përputhet me listë pagesat e punonjësve për këtë periudhë e vërtetuar kjo me listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve;

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 10. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

-Argumentim: Kërkesa është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllëgoar duke u bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të referencës. Numri i

punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë listë pagesat e shoqëruara me formularët e deklarimit të pagesave shoqërore dhe shëndetësore me këtë kohështirje është

dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

3. Mbeshtetje subjektive nuk lejohet për kriteret e mëposhtme:

-Për të provuar përvojën e mëparshme (shërbime të ngjashme):

Pika 2.3.1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

-Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës):

Pika 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

Argumentimi ligjor: Në mbështetje të Nenin 84, pikat 6 dhe 7 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” te ndryshuar; Nenin 88, Neni 90, pikat 5 dhe 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera sipas pikës 2.16 të DST-ve.

Argumentimi teknik: Autoriteti Kontraktor për zbatimin dhe realizimin e objektit me sukses dhe cilësi do të gjykojë mbi përvojën e mëparshme të operatorit i cili do të zbatojë këtë kontratë dhe jo në përvojën e një operatori tjetër, i cili i mbështet thjesht për t’u kualifikuar por nuk merr përsipër të kryej asnjë shërbim gjatë zbatimit. Do ishte një vlerësim jo korrekt nga ana e autoritetit nëse do lejonte mbështetjen në përvojë të ngjashme dhe operatori i cili do të fitonte kontratën nuk do të kishte përvojën e duhur, si dhe për më tepër të mbajë përgjegjësi për mos përmbushje të kontratës. Në rastin e një bashkimi operatorësh kërkesat për kualifikim, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuaranë aktmarrëveshje. Gjithashtu, lejimi i mbështetjes në subjekte të tjera përbën një risk shumë të madh për zbatimin e kontratës dhe përfundimin e saj me standard dhe cilësi. Licenca është dokument juridik e profesionale, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas kriterëve të licencave. Duke u nisur nga këto fakte, gjykojmë se një operator ekonomik nuk do të realizonte me sukses zbatimin e kontratës në qoftë se nuk do të dispononte pikën e licencës për atë kategori dhe përvojën e ngjashme. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se AK nuk kufizon mundësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë për të përmbushur këto kriteret.

Argumentimi i Termave të Referencës

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termet e references janë hartuar sipas standardeve dhe në përputhje me perçkatimet ligjore në fuqi dhe janë pjesë e pandare e DST. Ky dokument përmban Termet e Referencës (ToRs) për Shërbimin e Projektimit dhe Mbikëqyrjes me qëllim garantimin e cilësisë, përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi dhe realizimin korrekt të projektit dhe mbikëqyrjes për: “Ndërhryet e përmirësimit të shtresave asfaltike Qarku (Elbasan, Korçë, Berat, Vlorë, Fier dhe Gjirokastrë)”. Ndërhryja është pjesë e Programit Operacional të FSHZH 2024-2030, miratuar nga Këshilli Drejtues i tij dhe konkretisht në detajimin financiar 2026-2029. Synimi kryesor është përmirësimi i transportit dhe aksesit nëpërmjet ndërhryes në shtresa asfaltike me qëllim transformimin e konektivitetit rajonal dhe vendor midis zonave urbane kryesore, zonave ekonomike, zonave prodhuese dhe qendrave të shërbimeve, gjithashtu edhe rritjen e cilësisë së lidhshmërisë mes qarqeve dhe zonave në brendësi të tyre, përmes rritjes së përmirësimit të sigurisë, ndriçimit, sinjalistikës dhe komoditetit të transportit rrugor në akset rrugore.

Ndërhryja për përmirësimin e shtresave rrugore synon forcimin e lidhshmërisë rajonale dhe vendore ndërmjet zonave kryesore urbane, zonave ekonomike dhe prodhuese, si dhe qendrave të shërbimeve. Kjo do të realizohet nëpërmjet përmirësimit të shtresave asfaltike, rritjes së sigurisë rrugore, përmirësimit të ndriçimit dhe plotësimit të sinjalistikës në akset rrugore rajonale e lokale, të cilat shërbejnë zona me potencial të lartë turistik dhe ekonomik dhe kanë një numër të konsiderueshëm përdoruesish.

Gjendja e amortizuar e infrastrukturës rrugore përbën një nga pengesat kryesore për lëvizjen e njerëzve dhe mallrave, nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja, zhvillimin e turizmit, rritjen ekonomike, si dhe aksesin në shërbime sociale dhe mundësi punësimi. Kjo problematikë është veçanërisht e ndjeshme për banorët e zonave rurale, por ndikon gjithashtu edhe në funksionimin e përgjithshëm të territorit. Infrastruktura rrugore përfaqëson një nga asetet më të rëndësishme publike të vendit dhe, së bashku me sistemin e transportit, ka një rol thelbësor në zhvillimin ekonomik dhe territorial.

Projekti për përmirësimin e shtresave rrugore, i shoqëruar me ndërhyrje në sinjalistikë dhe elemente të sigurisë rrugore, përbën vijimësi të përvojës pozitive të krijuar nga FSHZH në zbatimin e paketave të mëparshme infrastrukturore. Këto ndërhyrje kanë kontribuar në përmirësimin e aksesit në të gjithë territorin e vendit, duke ofruar një zgjidhje më efikase dhe me kosto dukshëm më të ulët krahasuar me rindërtimin e plotë të infrastrukturës rrugore. Qëllimi i projektit është përmirësimi i shtresave asfaltike në akset rrugore të përfshira në ndërhyrje, me synim rritjen e sigurisë rrugore, përmirësimin e cilësisë së lëvizjes dhe reduktimin e kostove të udhëtimit e të mirëmbajtjes. Ndërhyrjet synojnë gjithashtu rritjen e cilësisë së lidhshmërisë ndërmjet rajoneve dhe zonave në brendësi të tyre, përmirësimin e aksesit drejt qendrave urbane, ekonomike, prodhuese dhe të shërbimeve, si dhe rritjen e komoditetit të transportit rrugor nëpërmjet përmirësimit të sinjalistikës, ndriçimit dhe elementeve të sigurisë. Zbatimi i këtyre ndërhyrjeve pritet të ndikojë në uljen e numrit të aksidenteve në segmentet e investuara, në rritjen e vlerës së pronave përgjatë akseve rrugore dhe në përmirësimin e kushteve të përgjithshme të zhvillimit socio-ekonomik të zonave përfituese. Ndërhyrjet e kësaj pakete do të përfshijnë:

- Frezim i shtresës ekzistuese asfaltike në segmentet ku konstatohet dëmtim, konsumim ose deformim i sipërfaqes rrugore, me qëllim përgatitjen e bazës për ndërhyrjet pasuese.
- Trajtim i sipërfaqes rrugore ekzistuese, në varësi të gjendjes teknike të saj, për përmirësimin e qëndrueshmërisë, nivelimit dhe cilësisë së qarkullimit.
- Riparim pjesor i shtresave rrugore në zonat ku evidentohen çarje, gropa, ulje lokale, dëmtime të bazamentit apo problematika të tjera që ndikojnë në sigurinë dhe komoditetin e lëvizjes.
- Ndërhyrje të kombinuara në shtresat rrugore, sipas nevojave konkrete të evidentuara gjatë verifikimit në terren dhe vlerësimit teknik të çdo segmenti.
- Përmirësim i shtresave asfaltike për rritjen e jetëgjatësisë së rrugës, uljen e kostove të mirëmbajtjes dhe përmirësimin e kushteve të transportit rrugor.
- Plotësim ose përmirësim i elementeve të sigurisë rrugore, përfshirë sinjalistikën horizontale dhe vertikale, aty ku do të rezultojë e nevojshme nga analiza teknike.
- Përmirësim i kushteve të drenazhimit dhe largimit të ujërave sipërfaqësore në segmentet ku problematika e kullimit ndikojnë në dëmtimin e shtresave rrugore.
- Aplikim i ndërhyrjeve të përshtatura sipas tipologjisë së rrugës, intensitetit të trafikut, gjendjes ekzistuese të shtresave dhe rëndësisë funksionale të segmentit në rrjetin rrugor lokal apo rajonal.
- Vendosje dhe përmirësim i elementeve të sinjalistikës horizontale dhe vertikale, si dhe i pajisjeve dhe masave plotësuese për rritjen e sigurisë rrugore në segmentet ku do të kryhen ndërhyrjet

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A)¹ Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

- | | |
|----------------------------|-----------------|
| 1. Çmimi | pikët 50 |
| 2. Propozimi teknik | pikët 50 |

¹ Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

(i)	Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar	0 - 20
(ii)	Metodologjia e Propozuar	0 - 10
(Përqasja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)		
(iii)	Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit	0 - 20

1 Kriteri Çmimi [50] pike

Kriteri i cmimit me 50 pikë është i bazuar ne rregullat e prokurimit publik, ku parashikohet minimalisht 50 pike.

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe - Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu - Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç - Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Çmimi (në përputhje me kerkesat e VKM nr.354 datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit).

Llogaritja bëhet duke u mbështetur në VKM nr. 354, datë 11/05/2016 (Për miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim)

Vlera minimale pa tvsh 23,718,015 lekë, Vlera maksimale pa tvsh 26,755,372 lekë

Argumentimi: Kriteri i mësipër është përcaktuar bazuar në Nenin 45 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar

2 Kriteri Propozimi teknik [50] pike

Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

- i) **Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar / Projektim dhe Mbikqyrje**
[0- 20]

Nenkriteret

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm për projektim, mbikëqyrjen [5-20 %]

b- Eksperienca në fushën përkatëse projektim, mbikëqyrje [30-80 %]

Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.

Eksperiencia në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

- *Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4, nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Operatori Ekonomik për t’u vlerësuar për këte kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën e stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, ku cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës.

ii) Metodologjia e Propozuar / Projektim dhe Mbikqyrje

[0 – 10]

(Përqasja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)

Nenkriteret

- | | |
|--|----------|
| ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia | [10-30%] |
| ii/b. Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projekti/objekt | [30-40%] |
| ii/c. Organizimi i Stafit | [10-30%] |

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme, duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit/objektit: Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t’i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

ii/c. Organizimi dhe Stafi: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Metodologjia që ndiqet për realizimin e projekteve ka për qëllim të përfshijë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përfaqshjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Metodologjia duhet të tregojë aftësinë për t’i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkrete. Përmbanë menaxhimin dhe përgjegjësitë kryesore të grupit të zbatimit të projektit. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull

Metodologjia që ndiqet për realizimin e mbikëqyrjes së punimeve synon të garantojë cilësinë e ndërtimit të objektit, të kontrollojë cilësinë e materialeve që do të përdoren në objekt referuar me specifikimet teknike të projektit, kontrollin e zbatimit të grafikut të punimeve, kontrollin sasior të volumeve të preventivit, si dhe zgjidhjen e problemeve teknike apo organizative që dalin gjatë zbatimit të punimeve në objekt. Metodologjia do të ketë një rol të rëndësishëm në zbatimin e projektit. Metodologjia prezanton gjithashtu detyrat dhe strukturën organizative të grupit të zbatimit të punimeve..

(iii) Përvoja për Punë të Ngjashme të Projektuesit/ Mbikqyrësit [0 – 20]

Nënkriteret

iii/a Përvoja për punë të ngjashme projektues, mbikëqyrës 40-80%

Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

iii/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë 10-20%

Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të ligjit 162/2020, Referuar në nenin 79 parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë” dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Certifikata e standadeve të cilësisë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përlogariten sipas formulës:

$$Pk1 = V_{min} k1 \times P_{max} k1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{min} k1 Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{max} k1 Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Oferta më e mirë $Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$

Piket dhe pesha e vendosur për secilin nenkriter gjatë zhvillimit të fazës së minikonkursit, do të variojnë brenda kufijve të përcaktuar më sipër.